



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

DREJTORIA VENDORE KORÇË

Nr. 3648/2 Prot.

Korçë, më 08.08.2023

Lënda: Kërkesë për publikim.

Zyra e Protokollit  
Nr. 4287 Prot.  
Data: 11.8.2023  
Dau'sca Lulaj Ar

NJËSISË ADMINISTRATIVE POJAN ✓

Brenda kompetencave institucionale dhe tagrit ligjor të garantuar nga Ligji nr.111/2018 „ Për Kadastrën“, Ligjit nr. 20 dt.05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1040/2020 “ Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje” Drejtoria Vendore e ASHK-së Korçë ka miratuar Vendimet për legalizimin e ndërtimeve pa leje në favor të subjekteve të poshtëshënuar.

Në zbatim të pikës 31 dhe 32 të VKM-së 1040/2020 ku parashikohet që “ Lista e subjekteve përfutuese të ndërtimeve të legalizuara, shoqëruar me të dhënat e pasurive, si adresa , zona kadastrale, numri i pasurisë publikohet në ambientet e ASHK-së, pranë njësisë së vetqeverisjes vendore, si dhe në faqen zyrtare të internetit të ASHK-së” dhe “ Subjektet e interesuara në përputhje me afatet e përcaktuara në dispozitat e Kodit të Proçedurave Administrative, kanë të drejtë të paraqesin ankim administrativ për vendimin e legalizimit , pranë strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së”, për sa më sipër kërkojmë:

- Publikimin për afatin 30 (tridhjetë) ditor në ambientet e Institucionit tuaj së listës së mëposhtme të subjekteve përfutuese të ndërtimeve të legalizuara.
- Çdo subjekt i cili ka pretendim apo ankesë në lidhje me vendimin e legalizimit është i lutur ti drejtohet strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së.
- Në përfundim të afatit jeni të lutur të konfirmoni nëse ka apo jo kërkesë/ankesa nga subjektet

Bashkëngjitur shkresës po ju vemë në dispozicion:

- Tabelën me listën emërore të subjekteve përfutuese ku janë të përcaktuara të dhënat e pasurisë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTORI

Ndriçim Hoxha

Ndricim  
Hoxha

Digitally signed by  
Ndricim Hoxha  
Date: 2023.08.08  
16:18:18 +0200



Vulosur dhe miratuar nga Drejtoria e Korçës, Nr. 109 Prot  
Data: 11.08.2023  
10SUKORCE2023080908493621014

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë

390 REPUB  
AGENCIJA S

Emer	Atësi	Mbiemer	Të dhënat e pasurisë		
RAFAIL/PARASHQEVI	PETRO/JANAQ	JORGJI	2902	PENDAVINJ	19/4/1
	KOASH- KISHA "SHEN VANGJELIZMOJ"		2902	PENDAVINJ	39/24/1
ARVIT/SONILA	FAREDIN/LUAN	MULLALLI	3903	ZEMBLAK	183/16/1